



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS FRËNGE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
Kërkim Shkencor

Ngarkesa: 6 kredite; 60 orë mësimore; 30 leksione 30 seminare;
Viti akademik/semestri kur zhvillohet: Viti II, semestri I
Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme
Programi i studimit: Master në Përkthim teknik-letrar dhe Interpretim
Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Kjo lëndë pretendon të japë një panoramë të përgjithshme dhe praktike të punës kërkimore shkencore në lëmin e përkthimit duke u marrë me tema të vecanta që prekin interesin e përgjithshëm dhe që bazohen në punën individuale dhe në grup të studentëve.

Objektivat e përgjithshme lëndore: Të arrijë të marrë njohuritë bazë të lëndës Metodologji e kërkimit shkencor (kryesisht në përkthim). Të mësojë të kërkojë dhe të organizojë e sistemojë informacionin. Të mësojë të planifikojë punën sipas etapave të caktuara Të analizojë dhe të formojë një gjykim personal, të arsyeshëm dhe aktiv mbi burimet e ndryshme dhe literaturën e shfrytëzuar.

Objektivat specifike lëndore:

Studenti duhet: të njohë se si:

- të zgjedhë një temë të caktuar në fushën e përkthimit apo të interpretimit, të hartojë një problematikë në lidhje me të dhe të shtrojë pyetje rreth kësaj problematike.
- të hartojë një plan duke u nisur nga një ide e caktuar.
- të kërkojë, të analizojë dhe të përzgjedhë informacionin në varësi të temës së përzgjedhur.
- të dokumentojë materiale arkivore, audio dhe video sipas standardeve franceze (ose europiane) të citimit.
- të hartojë një tekst të qartë me strukturë logjike.
- të referojë e të bëjë të njohur rezultatet e kërkimit të tij.